



BASHKIA E TIRANËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Nr. prot. 5324/1 dt. 24.05.2012
ndërmjet

Bashkisë së Tiranës,

Shkollës 9-vjeçare “Shkolla e Kuqe”, Tiranë

dhe

Grupit të të rinjve të Njesisë Bashkiake nr. 8

Nënshkruar sot në Tiranë, më _____ 2012

Ky memorandum hartohet ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe Shkollës 9-vjeçare “Shkolla e Kuqe” dhe grupit të të rinjve të Njesisë Bashkiake nr. 8 (këtu e në vijim të quajtura palët) për projektin “Krijimi i terreneve sportive, mjediseve për pushim dhe argëtim” i zhvilluar në kuadër të nënkomponentit C të projektit “Youth Empowerment through Community Development” (YECD).

Projekti do të implementohet në ambientet e “Shkollës së Kuqe” dhe do të përfshijë të rinjtë e shkollës dhe komunitetit të zonës së Njesisë Bashkiake nr.8.

Në kuadër të këtij projekti në ambientet e Shkollës 9-vjeçare “Shkolla e Kuqe”, e vendosur në Njesisë Bashkiake nr.8, do të krijohen ambiente sportive, pushimi e argëtimi: fushë sportive shumëfunktionale (basketbolli, volejbolli dhe minifutbolli) dhe kënde lodrash për fëmijët parashkollorë, si një premisë për zhvillimin e aktiviteteve të projektit.

Nëpërmjet këtij Memorandumi Bashkëpunimi, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi:

Qëllimi i këtij "Memorandumi Bashkëpunimi" është koordinimi dhe zbatimi i aktiviteteve të projektit "Krijimi i terreneve sportive, mjediseve për pushim dhe argëtim".

Neni 2
Detyrimet e palëve

2.1 Bashkia e Tiranës merr përsipër:

- a. Të krijojë Komitetin e projektit me përfaqësues nga Drejtorja e Rinisë dhe Sporteve në Bashkinë e Tiranës, shkolla 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe" dhe komuniteti i të rinjve të zonës, i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e aktiviteteve të projektit.
- b. Të hartojë, në bashkëpunim me përfituesit e projektit (grupin e të rinjve dhe stafin e shkollës) dhe të paraqesë pranë Njesisë së Koordinimit të Projektit YECD, projekt propozimin "Krijimi i terreneve sportive, mjediseve për pushim dhe argëtim".
- c. Të hartojë në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe" dhe grupin e të rinjve, planin vjetor të aktiviteteve të projektit.
- d. Me anë të financimit të JSDF (Japan Social Development Fund), nëpërmjet Njesisë së Koordinimit të Projektit YECD, do të krijojë terrene sportive, pushimi dhe argëtimi në përputhje me projekt propozimin e hartuar nga partnerët e projektit.
- e. Të kujdeset mbas investimit të bërë për mirëmbajtjen në vazhdimësi të ambienteve të krijuara nëpërmjet Drejtorisë nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit.
- f. Të ngarkojë strukturën përkatëse në bashki e cila do të angazhohet në realizimin e aktiviteteve të projektit në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe".
- g. Të përdorë në vazhdimësi këto ambiente të krijuara edhe pas përfundimit të këtij projekti, për aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me palët e tjera, për eventet e planifikuara në kuadër të projekteve të tjera me impakt komunitar, social, sportiv, rinor, etj.

2.2 Shkolla 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe" merr përsipër:

- a. Të vërë në dispozicion të projektit "Krijimi i terreneve sportive, mjediseve për pushim dhe argëtim", ambientin ku do të zbatohet projekti.
- b. Të marrë në dorëzim investimin e mundësuar nga projekti dhe të përgjigjet për mirëmbajtjen e ditëpërditshme dhe ruajtjen e ambienteve të krijuara.
- c. Të përdorë terrenet sportive të pushimit dhe argëtimit për realizimin e aktiviteteve ndërmjet të rinjve të shkollës si dhe të jetë e hapur për aktivitete që do të realizohen me të rinjtë e komunitetit, sipas planit të aktiviteteve të miratuar paraprakisht nga Komiteti i Projektit.

- d. Të caktojë stafin përkatës që do të angazhohet në realizimin e aktiviteteve të projektit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.
- e. Të dokumentojë të gjitha aktivitetet e realizuara nga shkolla në kuadër të projektit nëpërmjet fotove, video-regjistrimeve të aktiviteteve apo proces verbaleve të mbajtura.
- f. Të vërë në dispozicion dhe në vazhdimësi ambientet e krijuara për aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për eventet e planifikuara në kuadër të projekteve të tjera me impakt komunitar, social, sportiv, rinor, etj.

2.3 Grupi i të rinjve merr përsipër:

- a. Të angazhohet dhe të marrë pjesë në hartimin dhe realizimin e aktiviteteve të projektit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe "Shkollën e Kuqe".
- b. Të bëhen pjesë dhe të përfshihen në vendimmarrjen e Komitetit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Neni 3
Dispozita të fundit

3.1 Palët përgjigjen për respektimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi.

3.2 Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët dhe do të jetë i vlefshëm për një periudhë 3 vjeçare, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi.

3.3 Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet në 6 kopje, nga 2 kopje për secilën palë.

Për Bashkinë e Tiranës

Znj. Jorida TABAKU
Zv. Kryetare



Për shkollën 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe"

Z. Ramazan FEJZO
Drejtor



Për grupin e të rinjve

Eni Gjyzeli

